

FJALA E DEPUTETIT ARBEN PËLLUMBI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Diskutimi i buxhetit të vitit të ardhshëm është një nga çështjet më të rëndësishme, më të debatueshme dhe pa diskutim me më shumë impakt të drejtpërdrejtë në jetën e çdo qytetari, ndaj duhet të jemi sa më seriozë në atë çfarë themi. Dëgjuaam sot në mëngjes zotin Basha, që foli herë si një socialdemokrat i mirëfilltë dhe herë si një populist, por dhe shumë kolegë të opozitës, që u përpoqën të bëjmë demagogji dhe pretenduan se ky buxhet nuk u vjen në ndihmë shqiptarëve. Nuk dua të bëj polemikë me askënd, por mendoj se gjërat duhen thënë siç janë. Fjalët i merr era, por shifrat mbeten aty, të pandryshueshme.

Dëgjova një zonjë që nuk na quan kolegë, që deklaroi se qeveria jonë “hajdute” uli taksën e plastikës në paketën fiskale të para 3 vjetëve, pra për vitin 2019, në 35 lekë për kilogram dhe 25 lekë për kilogram për produktin vendas. E nderuar zonjë, më lejoni t’ju sqaroj se nuk kishte taksë plastike. Në atë paketë fiskale e vendosëm ne taksën për plastikën, 35 lekë për të gjitha produktet e importit dhe 10 lekë për produktet e vendit, duke pasur parasysh shishet plastike në funksion të një ambienti më të pastër, luftë të cilën po e vazhdojmë edhe sot. Pra, ishte zero. Paketa e arsimit në këtë projektbuxhet ka arritur për herë të parë në 3,6% të GDP-së. U është dhënë mbështetje të gjitha shtresave sociale që punojnë apo çojnë fëmijët e tyre në sistemin shkollor publik dhe sigurisht këtu nuk kanë lidhje fëmijët e oligarkëve. Paketa e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale ka arritur për herë të parë në 3,5% të GDP-së, kur mesatarja e 10 viteve të fundit ka qenë nga 2,8 deri në 3%. Kaq besoj mjafton për të kuptuar se ky buxhet, pa më të voglin dyshim, është buxheti me paketën më të madhe sociale dhe mbështetje për shtresat në nevojë, që ka pasur ndonjëherë shteti shqiptar. Dëgjova këtu se buxheti nuk jep impluset e duhura për rimëkëmbjen ekonomike. Mesa duket harrojnë ose bëjnë sikur harrojnë se, pavarësisht efekteve të pandemisë globale COVID- 19, por edhe pasojave që solli tërmeti i 26 nëntorit 2019, ekonomia performoi më mirë nga sa ishin edhe parashikimet e institucioneve financiare ndërkombëtare. Mjafton të hapni raportet për vitin 2020 dhe do të shihni se institucionet ndërkombëtare, si: FMN-ja, Banka Botërore, Komisioni Europian, BERZH-i etj, parashikuan recesion deri në 9%, ndërkohë që zyrtarisht u regjistrua një recesion prej 3.96%. Kjo pa diskutim erdhi fal reformave dhe politikave të duhura, që u ndërmorën nga qeveria shqiptare, nga kjo maxhorancë. Projektionet dolën të sakta dhe ekonomia arriti të rikthehej në norma të larta rritjeje, ku për vitin 2022 parashikohet një rritje të ekonomisë me 4,1%, duke mbajtur një nivel mesatar prej mbi 4% për vitet pasuese 2023 dhe 2024.

Të nderuar kolegë,

Nuk dua të përsëris se çfarë u tha më parë, por dua të fokusohem në mbështetjen buxhetore që qeveria ka planifikuar për sektorë prioritarë për ekonominë, si: bujqësia, mjedisi dhe energjia. Për efekt kohe e kam të pamundur të përmend të gjitha ato që parashikohen në buxhet, por do të ndalem në disa pika që i konsideroj të rëndësishme. Bujqësia vijon të mbetet një sektor, për të cilin kjo maxhorancë ka vizionin e qartë si mund të zhvillohet. Ky buxhet ka parashikuar mbështetjen më të

lartë të drejtpërdrejtë, të dhënë ndonjëherë në bujqësi prej 7,1 miliardë lekësh fonde në dispozicion vetëm për financimin e zhvillimit rural, ndër të cilat 3,2 miliardë lekë përbëjnë mbështetje për rreth 40-50 mijë fermerë dhe 2,2 miliardë lekë për programin IPARD, për realizimin e rreth 200 investimeve në proces, si dhe rreth 400 milionë lekë mbështetje për start up-et në bujqësi dhe për projekte të tjera mbështetëse në bujqësi. Sa për qumështin pluhur, i nderuar koleg, më lejoni t'ju them se përjashtohen nga taksa ata, të cilët e importojnë këtë produkt si pjesë të skedës së tyre të prodhimit, sepse qumështi pluhur nuk është i ndaluar të përdoret, por përdoret atje ku është i lejuar të përdoret, dhe ne po vendosim një taksë pikërisht për të ndaluar keqpërdorimin e tij. Prandaj të mos abuzojmë me këtë dhe të mos shpërndajmë tek ata që na dëgjojnë atë që nuk është e vërtetë dhe nuk është e drejtë. Gjithashtu, çka nuk duhet të na kalojë pa vëmendje është mbështetja buxhetore që do të jepet për sigurinë ushqimore. Ky sektor do të ketë buxhetin më të lartë ndonjëherë me 2,3 miliardë lekë, do të shtojmë laboratorët e kontrollit modern dhe 120 grupet e AKU-së do të pajisen me teknologji për kontrolle eficiente dhe cilësore, si dhe do të matrikulohet, vaksinohet dhe gjurmohet i gjithë kapaciteti blegtoral, si pasuri kombëtare. Njëpërmjet forcimit të dy autoriteteve kontrolluese, që mbulojnë tashmë të gjithë spektrin e kontrollit për ushqimin, veterinarinë dhe bimët, do të sigurohet një efektivitet kontrolli nga ferma te produkti final, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, por edhe garantimin e produkteve "Made in Albania", si ato që konsumojmë brenda vendit dhe ato për eksport, duke na rritur akoma më shumë mundësinë që të shtrihemi në më shumë tregje ndërkombëtare.

Sa i përket mjedisit, në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar që të ketë mbështetjen e duhur për pastrimin e territorit dhe të mbetjeve, ndërkohë që një fond shtesë do të alokohet për 4 bashki bregdetare, që kanë edhe fluksin më të madh të pushuesve gjatë sezonit turistik: Durrësi, Kavaja, Saranda dhe Himara. Ndërkohë që edhe menaxhimi i mbetjeve urbane do të ketë një fokus të veçantë nëpërmjet zbatimit të disa projekteve në Fier, Durrës, Shkodër dhe Himarë. Për sa i përket energjisë, në vitin 2022 nuk do të mungojë mbështetja buxhetore për konkretizimin e një prej prioriteteve të kësaj maxhorance "Zhvillimi i politikave dhe strategjive për një ecuri të qëndrueshme të sektorit të energjisë dhe eficiencës në energji". Në projektligjin e buxhetit të vitit 2022 tavanet në programin e energjisë janë rritur në total 223,4 milionë lekë dhe prioritetet janë: - Zhvillim i qëndrueshëm i ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale. Dua të ritheksoj edhe unë që nuk do të mungojë mbështetja për konsumatorin familjar, si dhe biznesin e vogël, në raport me çmimin e energjisë, pavarësisht konjunkturave mjaft të larta të blerjes sot në të gjitha tregjet ndërkombëtare. - Diversifikimi i furnizimit me burime energjetike dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe europiane, duke nxitur investimet dhe duke përmirësuar arkëtimet dhe likuiditetet. - Në vitin 2022 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2021. - Në vitin 2022 do të rritet eficientia e energjisë me 6,5%, referuar vitit 2020. Me shumë kënaqësi do të theksoja se ndër projektet kryesore që lidhen me eficientën e energjisë dhe që do të sigurojnë mbështetje buxhetore janë: - Projekti pilot për "2 kilometra smart city - rruga e energjisë së pastër". - Standardet e ndriçimit urban dhe rrugor në Republikën e Shqipërisë. - Studimi i fizibilitetit për vendosjen e kullave të karikimit për makinat elektrike në Republikën e Shqipërisë. - Projektide për elektrifikimin e linjave të transportit urban dhe ndërqytetas në bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Durrës. - Përmirësimi i eficiencës së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza. - Përmirësimi i eficiencës së energjisë në impiantet e furnizimit me ujë, sigurisht, edhe zëri i TVSH-së dhe i kostove lokale për projektet me financim të huaj.

Pa diskutim, një nga projektet më të rëndësishme do të jetë mbështetja për rehabilitimin e agregatëve të hidrocentralit të Fierzës, i cili përbën njësinë gjeneruese më të rëndësishme të sistemit elektroenergjetik shqiptar dhe që prodhon mbi 1300 GWH/vit, por edhe fillimi i zbatimit të kontratës për ndërtimin e një vepre shumë të rëndësishme hidroenergjitike siç është hidrocentrali i Skavicës, i

cili, në thelb, do të ketë sigurinë energjetike dhe do ta kthejë Shqipërinë në vend eksportues neto të energjisë elektrike. Dua të ndalem shkurt edhe në mbështetjen buxhetore për rijetësimin e transportit hekurudhor dhe integrimin e sistemit hekurudhor shqiptar me atë rajonal dhe europian. Buxheti për këtë program është parashikuar 2, 77 miliardë lekë dhe projektet bazë për realizimin e objektivave për periudhën afatmesme 2022 - 2024 konsistojnë në: 1- Rikostruksionin e segmentit TiranëDurrës, ndërtimi i linjës së re Tiranë – Rinas. 2- Studime fizibiliteti dhe projekte zbatimi për segmente ekzistuese dhe për projekte të reja hekurudhore. 3- Vazhdimi i financimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore dhe mjeteve përkatëse. Më konkretisht, në projektligjin e buxhetit të vitit 2022 ka rritje të tavanit buxhetor me 648 milionë lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2021 dhe në shpenzimet korrente peshën kryesore e zë subvencioni i hekurudhës Shqiptare në vlerën 397 milionë lekë. Ato që rendita më sipër mund të duken projekte ambicioze, disa mund t'i quajnë dhe projekte 3D, por mjafton të pranosh realitetin dhe të mos mohosh se si po jetësohen disa prej projekteve infrastrukturore dhe premtimeve të kësaj maxhorance, që, pa diskutim, po tregojnë se i qëndron besnikë kontratës për të bashkëqeverisur me dhe për qytetarët edhe në këtë mandat të tretë qeverisës. Vetëm para pak ditësh nisi të kthehet në një projekt konkret rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë-Durrës. Vetëm dje nisi puna për hapjen e tunelit të Llogorasë, që plotëson gjerdanin infrastrukturor të Jugut, ndërkohë që më 29 nëntor do të hapet Rruga e Arbrit. Tri vepra konkrete, tri premtime të mbajtura, tri dëshmi që realizojmë atë çka premtojmë dhe, mbi të gjitha, tri dëshmi që edhe projektet e parashikuara në buxhetin e vitit 2022 do të bëhen realitet.

Ndaj, ju ftoj të japim mbështetjen tonë dhe ta votojmë këtë projektbuxhet që, mbi të gjitha, do të jetë në shërbim të çdo qytetari. Faleminderit!